

Hivzi Islami

ZHVILLIMI I KOMPONENTEVE TË DINAMIKËS NATYRORE TË POPULLSISË SË KOSOVËS

Në botë sot ekzistojnë vise me shkallë të ndryshme zhvillimi ekonomik, shoqëror, politik, kultural etj., në të cilat edhe situata demografike, në pajtim me këtë strukturë jo të njejtë, është e ndryshme. Edhe Jugosllavia, meqë ç'prej kohësh është zhvilluar në kushte të ndryshme historike, politike, ekonomike, sociale dhe kulturele, paraqet një botë në vete si për nga situata shoqërore, ekonomike dhe kulturele, ashtu edhe për nga zhvillimi demografik. Karakteristikat regjionale të zhvillimit të popullsisë janë aq të theksuara sa që në këtë hapësirë, relativisht të vogël, gjenden kontraste me karakter botëror. Prandaj, Jugosllavia është ende vend tipik për studimin e dukurive dhe të proceseve demografike.

Derisa disa vise të Jugosllavisë i karakterizon presioni i fortë demografik, që rrjedh nga shtimi ekspansiv natyror, të tjerave i kërcënohet rreziku nga lëvizjet depopullative, relative dhe absolute, që është rezultat i shkallës shumë të ulët të natalitetit dhe të shtimit natyror dhe emigracioneve masovike.¹ Ndërsa disa hapësira të tjera gjenden diku në mes të atyre në pikëpamje demografike ekspansive dhe depopullative. Kjo don të thotë se disa pjesë të Jugosllavisë e kanë kaluar periudhën e transicionit demografik ose gjenden në fazën e fundit të transformimit demografik, ndërsa të tjerat, si p.sh. Kosova, gjendet në nënetapën e hershme të fazës kaluese demografike.²

¹ Depopullacioni është proces negativ në lëvizjen e popullsisë. Paraqitet si rezultat i disa komponenteve të zhvillimit të popullsisë, si janë lëvizja natyrore dhe migracionet e popullsisë. Nëqoftë se procesin e depopullacionit e shkakton rënia e natalitetit, gjë që është pasojë shumë negative jo vetëm e lëvizjes natyrore të popullsisë, por edhe e zhvillimit të përgjithshëm demografik, atëherë ky proces njihet si denatalitet (*Višejezički demografski rečnik, Centar za demografska istraživanja, Institut društvenih nauka, Beograd 1971, f. 83*). Fenomeni i depopullacionit është karakteristikë për shumë vise të vendit tonë. Kosova, me përjashtim të vendbanimeve të banuara nga popullsia joshqiptare, nuk e njih këtë proces, por vetëm shtimin, madje shtimin ekspansiv.

² Për etapat e transicionit demografik në Jugosllavi, prej më të hershmes e deri në më të vonshmen sipas viseve shih imtësisht: M. M a c u r a, *Razmišljanja povodom osnova demografske teorije, „Stanovništvo”, nr. 1, CDI, IDN, Beograd 1966, f. 5—24*; M. M a c u r a, *Savremeni tokovi i perspektive demografskog razvitka Jugoslavije. „Cvijićev zbornik”. U spomen 100 godišnjice njegovog rođenja, SANU, Beograd 1968, f. 275—289*; G r u p a u t o r e s h, *Fertilitet stanovništva u Jugoslaviji, CDE, IDN, Beograd 1972, f. 341—360*; A. W. B a l e t i ć, *Demografija (Stanovništvo i ekonomski razvitak), „Informator”, Zagreb 1973, f. 105—110, etj.*

Pra, disa vise të vendit tonë për nga tendencat e lëvizjeve demografike u përkasin viseve dhe popujve me strukturë më të zhvilluar shoqërore dhe ekonomike, kurse të tjerat (Kosova etj.) viseve dhe popujve me shkallë më të pazhvilluar ekonomike dhe shoqërore.

Për çdo vend ose vis, pa marrë parasysh se a është reproduksioni i popullsisë racionale apo jo, është me interes të posaçëm përcjellja sistematike e variabileve demografike, njohja e faktorëve që i kushtëzojnë proceset demografike dhe të vërejturit e pasojave të tyre. Kjo për arsye se edhe në rastin e ekspansionit, stagnimit dhe depopullacionit të popullsisë pasojat mund të jenë dhe shpesh janë negative. Këto procese të zhvillimit të popullsisë, u muar vesh, i përcjellin edhe ndryshimet dhe proceset e shumta të fenomeneve dhe të strukturave demografike. Njohja dhe përcjellja e situatës dhe e zhvillimit demografik është e domosdoshme sidomos për ato vende dhe vise në të cilat ajo zhvillohet në mënyrë të pakontrolluar në kuptim të shtimit të shpejtë të popullsisë, ose atje ku kontrollimi i lindjes dhe planifikimi i familjes, të shkaktuar nga industrializimi dhe urbanizimi i jetës, emigracioneve, faktorit psikologjik e të tjerë, është duke u zbatuar aq sa që është bërë problem serioz i përtrirjes normale të popullsisë, respektivisht është i tillë sa nuk siguron as reproduksionin e thjeshtë të popullsisë. Kjo aq më tepër imponon nevojën e studimit të popullsisë, sepse popullsia, si kategori e ndryshueshme në hapësirë dhe në kohë, është në interaksion të shumëduarshëm me faktorët biologjikë, ekonomikë, socialë, historikë, politikë, kulturalë, psikologjikë, tradicionalë, etj. Në formë të posaçme këta faktorë janë manifestuar dhe manifestohen në lëvizjen natyrore dhe në atë të përgjithshme të popullsisë së Kosovës.

Nga mesatarja jugosllave, deri më tash, siç dihet, gati në të gjitha elementet e zhvillimit të popullsisë, sidomos në pikëpamje të lëvizjes natyrore, janë dalluar Sllovenia, në një anë dhe Kosova, në anën tjetër, si dy ekstreme të theksuara jugosllave. Mirëpo, kohëve të fundit, sa u përket kompetenteve natyrore të popullsisë, rolin e Sllovenisë e ka marrë Kroacia,³ dhe në pikëpamje të disa elementeve demografikë edhe Vojvodina. Ndërsa Kosova ende e mban vendin e parë në të gjitha karakteristikat e dinamikës dhe të strukturës demografike, madje me një ndryshim shumë të madh. Kosova, siç dihet, i përket periudhës së hershme të transicionit demografik, respektivisht nënetapës së hershme të kësaj periudhe, të cilën e karakterizon shkalla shumë e lartë e natalitetit (fertilitetit), rënja rapide e mortalitetit, sidomos vdekjes infantile, shtimi shumë i lartë natyror dhe procesi jo i volitshëm i tërë kompleksit demografik. Ndërsa viset e tjera të vendit e kanë kaluar këtë fazë të transformimit demografik dhe kanë hyrë në nënetapën e vonë të transicionit demografik⁴. Mi-

³ A. W e r t h e i m e r—B a l e t i č, *Stanovništvo SR Hrvatske*, Studije, „Skolska knjiga”, Zagreb 1971.

⁴ M. M a c u r a, *Savremeni tokovi i perspektive demografskog razvitka Jugoslavije*, „Cvijićev zbornik”, SANU, Beograd 1968, f. 275—289.




Fig. 1. Shkallët mesatare vjetore të lëvizjes natyrore të popullsisë së Kosovës në periudhat përkatëse prej vitit 1911 deri më 1973

rëpo, duhet theksuar se kohëve të fundit, edhe në Krahinën e Kosovës, me lëvizjet pozitive ekonomike, sociale, kulturore, arsimore, shëndetësore etj., gjithnjë po vërehet tendenca e zhvillimit diçka më të volitshëm të popullsisë.⁵ Kjo tendencë pozitive është manifestuar sidomos në popullsinë urbane të Kosovës. Madje, popullsia urbane dhe vendbanimet e qyteteve të kësaj krahine janë bërë bartësit kryesor të diferencave regjionale dhe strukturale si në zhvillimin shoqëror-ekonomik, ashtu edhe në rrjedhimet demografike.⁶

Situata e ndërlikuar demografike e Kosovës është rezultat i rrethanave specifike, shoqërore-historike dhe politike në të kaluarën e afërme dhe të largët, si dhe i shkallës shumë të ulët të zhvillimit social-ekonomik, medicinal dhe kultural. Prandaj, disa elemente të kompleksit demografik dhe social të Kosovës, janë të njëjtë me zhvillimin e popullatave që kanë ekzistuar dhe ekzistojnë në shoqërinë paraindustriale dhe tradicionale. Kjo mund të vërtetohet në shembullin e lëvizjes së fertilitetit të grave të moshës 15-49 vjeçe. Ndërsa fertiliteti është një ndër karakteristikat më biodinamike të popullsisë, përndryshe për reproduksionin e popullsisë së Kosovës element shumë me rëndësi, dhe, në shkallën e tashme shumë të lartë (rreth 167 fëmijë të lindur të gjallë në 1000 gra të periudhës riprodutive 15-49 vjeç në vitin 1970), bazë e riprodhimit joekonomik të popullsisë së saj. Në vitin 1950 p.sh. shkallët e fertilitetit gati në të gjitha grupet e moshës të periudhës riprodutive ishin gati në nivel të njëjtë, madje prej periudhës 40 e më tepër vjeç në nivel edhe më të lartë në Kosovë se sa te 13 bashkësi popullore, gjeografikisht të izoluar ndërsa në pikëpamje sociale dhe ekonomike homogjene (9 nga Evropa para vitit 1800, dhe 3 nga Azia dhe një nga Afrika). Për këto popullata besohet se kanë pasur të ashtuquajturin „fertilitet natyror”.⁷

Edhe sot në Kosovë shkallët e natalitetit (fertilitetit) janë shumë të larta, diku, në disa komuna ose vendbanime edhe shkallët e mortalitetit. Këto shkallë, veçanërisht shkallët e natalitetit, janë në nivel të njëjtë me proceset vitale të viseve dhe të popullatave më të pazhvilluara të botës. Sa për krahasim të dinamikës natyrore demografike të Kosovës me vendet me shkallë të ndryshme zhvillimi ekonomik dhe shoqëror, po japim një pasqyrë të lëvizjes natyrore të popullsisë.

Nuk ka të dhëna për lëvizjen natyrore të popullsisë së Kosovës për një periudhë të gjatë, sikurse është rasti me shumë popullata të tjera, madje edhe të viseve të tjera të Jugosllavisë. Evolucionin i

⁵ D. B r e z n i k, *Tendencije u razvitku stanovništva Kosova*, „Obeležja” nr. 2, Priština 1973, f. 5—27.

⁶ H. I s l a m i, *Reperkusionet e lëvizjeve ekonomike dhe sociale në ndryshimet regjionale të zhvillimit demografik të Kosovës*, „Përparimi”, nr. 2—3, Prishtinë 1973, f. 95—115.

⁷ Burimi për 13 popullata: L u i s H e n r y, *La fécondité naturelle: observation — théorie — rezultats*, „Population”, Institut Fertilitet stanovništva u Jugoslaviji, IDN, CDI Beograd 1972, f. 73.

T a b e l a 1. Lëvizja natyrore e popullsisë së Kosovës, Jugosllavisë dhe vendeve të tjera karakteristike të botës në periudha të caktuara të pasluftës në promila⁸

Periudha	1946-1950	1951-1955	1956-1960	1961-1964	1965-1970
1	2	3	4	5	6
<i>Nataliteti</i>					
Suedia	18,2	15,2	14,2	15,0	16,1
Jugosllavia	28,8	28,1	24,1	21,7	19,1
Meksiko	44,4	44,9	45,9	45,5	43,2
India ⁹	—	43,1 (1951)	—	40,4 (1961)	40,0 (1971)
Shqipëria ¹⁰	35,2	39,8	41,0	38,5	34,9
Kosova	41,6	42,6	42,6	40,9	38,5
<i>Mortaliteti</i>					
Suedia	10,2	9,7	9,7	10,0	10,3
Jugosllavia	13,2	12,1	10,2	9,3	8,4
Meksiko	17,8	15,4	12,5	10,7	8,9
India	—	30,0 (1951)	—	20,9 (1961)	18,0 (1971)
Shqipëria	15,4	14,4	10,4	9,5	8,0
Kosova	15,3	18,6	14,9	12,8	9,2
<i>Shtimi natyror</i>					
Suedia	8,0	5,5	4,5	5,0	5,8
Jugosllavia	15,6	16,0	13,9	12,4	10,7
Meksiko	26,6	29,5	33,4	34,8	34,3
India	—	15,1 (1951)	—	19,5 (1961)	22,0 (1971)
Shqipëria	19,8	25,4	30,6	29,0	26,9
Kosova	25,8	24,8	27,4	28,4	28,7

lëvizjes natyrore të popullsisë së kësaj Krahine mund të përcillet prej vitit 1911 (Shih fig. 1). Mirëpo, edhe këto të dhëna të shumtën për nga kualiteti dhe përfshirja janë jo të plota, ndërsa për elementet e tjera të zhvillimit demografik jo vetëm që nuk ka të dhëna të sakta, por ato mungojnë krejtësisht, kështu që të dhënat mbi komponentet natyrore të popullsisë, me gjithë të metat që kanë, prapëseprapë merren si orientim i përafërtë për rekonstruktimin e retrospektivës demografike dhe sociale të Kosovës.

Nga figura 1. vërehet procesi shumë jo i volitshëm i lëvizjes së karakteristikave vitale të popullsisë së Kosovës, me oscilime bukur të theksuara. Rrjedhimet joracionale demografike të asaj kohe

⁸ Burimi për Suedinë Meksikon, Jugosllavinë dhe Kosovës: D. B r e z n i k *Demografski metodi i modeli*, IDN, CDI, Beograd 1972, f. 172, 188, 189; M. F r i g a n o v i ć, *Socijalna geografija I., Stanovništvo svijeta*, „Skolska knjiga”, Zagreb 1968, f. 65, 69, 73.

⁹ A l f r e d I n z a r d, *La population de l'Inde, Premiers résultats du recensement de 1971*, „Population”, nr. 6, Paris 1972, p. 1103.

¹⁰ Vjetari statistikor i RPSH 1969 dhe 1970, Drejtoria e statistikës Tiranë 1970; f. 26; Republika Popullore e Shqipërisë në jubileun e 30 vjetorit të themelimit të PPSH, Drejtoria e Statistikës, Tiranë 1971, f. 27.

janë të kuptueshme, sepse për zhvillimin e forcave prodhuese as që mund të flitet atëherë, por vetëm për prapambetjen e përgjithshme ekonomike e sociale, mjerimin dhe varfërinë. Shtimi natyror prej vitit 1911 deri në vitin 1920 është shumë i ulët, madje jo nga nataliteti i ulët që atëherë sillej në mes 38 dhe 40 promil, por pikërisht nga shkalla shumë e lartë e mortalitetit, që sillej në mes 34 dhe 38 promil. Kuptohet se për shkak të strukturës jo të zhvilluar ekonomike, sociale, medicinale dhe kulturele, nataliteti është dashur të jetë në nivel edhe më të lartë, madje edhe deri te kufiri fiziologjik. Mirëpo, për shkak të mortalitetit shumë të lartë, sidomos vdekjeve të foshnjeve dhe të grave të periudhës reprodutive, krejt popullsia femërore nuk e ka përjetuar tërë periudhën fertile. Kjo ka kushtëzuar mesataren shumë të ulët të jetës së tyre dhe të tërë popullsisë. Vdekja e popullsisë ishte masovike sidomos nga sëmurjet e ndryshme endemike dhe epidemike, sikurse janë malarja, difteria, tuberkulozi, mortaja etj. që bënin kërdi. Për këto arsye edhe numri i përgjithshëm i popullsisë herë rritej pak, herë stagnonte ose edhe zvogëlohej. P. sh. në periudhën 1911-1920 shtimi natyror ishte 2 deri 3 promil mesatarisht në vit. Kjo është edhe periudhë e ngjarjeve historiko-politike, respektivisht e Luftërave Ballkanike dhe e Luftës së Parë Botërore, në të cilat humbi jetën edhe një numër i konsiderueshëm i popullsisë së Kosovës. Sipas disa shënimeve në vitin 1910 në Kosovë jetonin 475.000 banorë,¹¹ ndërsa në vitin 1921, kur bëhet regjistrimi i parë i popullsisë së shtetit serbo-kroato-sllaven, në Kosovë shënohet numri më i vogël i popullsisë, rreth 440.000 banorë.¹²

Padyshim se rënia absolute e numrit të popullsisë së Kosovës, pos shtimit shumë të ulët natyror, është edhe rezultat i shpërnguljeve masive të popullsisë nga kjo trevë në Turqi.¹³

Pas luftës së Parë Botërore, respektivisht pas regjistrimit të vitit 1921, nataliteti në Kosovë rritet, e kjo tendencë zgjat deri në vitin 1925. Rritja e shkallës së natalitetit deri në kufirin fiziologjik (rreth 50 promil mesatarisht në vjet), sigurisht është pasojë e kompenzimit të popullsisë së humbur në Luftën e Parë Botërore e, ndoshta edhe imigrimeve të popullsisë nga territoret e tjera, e cila gjithashtu atëherë kishte shkallë relativisht të lartë të lindjeve. Kjo rritje e natalitetit, së bashku, me rënien e mortalitetit në këtë periudhë pesëvjeçare për disa promil, shkaktoi shkallën më të lartë të shtimit natyror, prej 2 deri në 3 promil në periudhën 1911-1920 në rreth 18 promil në periudhën 1921-1925. Në periudhat e tjera deri në vitin 1940 lëvizjen natyrore të popullsisë së Kosovës e karakterizon rënia graduale edhe e natalitetit edhe e mortalitetit, për çdo periudhë pesëvjeçare mesatarisht në vjet nga rreth 5 promil. Krahas evolucionit të këtyre proceseve vitale sillej edhe shkalla e shtimit naty-

¹¹ Kretanje stanovništva NRS od 1834. do 1953 godine, Zavod za statistiku NR Srbije, Beograd 1953, f. 42.

¹² *Po aty.*

¹³ M. K r a s n i ć i, *Savremene društveno—geografske promene na Kosovu i Metohiji*, Friština 1963, f. 23.

ror të popullsisë. U muar vesh se në këto procese të komponenteve natyrore të popullsisë kanë pasur efektet e veta edhe migracionet e popullsisë (emigracionet dhe imigracionet) që pikërisht atëherë kishin filluar të masovizoheshin nga motivet e ndryshme, më tepër me karakter politik.

Ndonëse për periudhën para vitit 1911 nuk ka kurrfarë të dhënash mbi lëvizjen natyrore të popullsisë së Kosovës, në bazë të moszhvillimit të përgjithshëm, si dhe trendeve të popullatave të viseve të ndryshme të botës, për të cilat ka shënime, mund të konkludohet se dinamika natyrore e popullsisë së kësaj treve ishte plotësisht identike me zhvillimin e popullatave që kanë jetuar në kushtet parai-




Fig. 2. Shkallët mesatare vjetore të lëvizjes natyrore të dy ekstremeve demografike — të Kosovës dhe të Sllovenisë në periudhat përkatëse prej vitit 1950 deri më 1971

ndustriale dhe tradicionale: shkalla shumë e lartë e natalitetit dhe e mortalitetit, kështu që shpeshherë shtimi natyror ishte zero. Pra, riprodhimi i popullsisë bëhej në kushte shumë të pavolitshme, me humbje të mëdha. Një ndër preokupimet themelore të popullsisë ishte si të ruajë në jetë bile një numër sado të vogël të fëmijëve. Prandaj, kushti i parë për këtë qëllim ishte të lindin sa më shumë fëmijë. Kjo psikologji e përtrirjes së popullsisë dhe ky element i progresit demografik, është veçori jo vetëm e kësaj periudhe, por edhe e asaj të pas vitit 1911, pas luftës, e në disa ambiente, por më pak, edhe sot.

Pas Luftës së Dytë Botërore u bën ndryshime rrënjësore në të gjitha sferat e jetës shoqërore-ekonomike dhe politike të vendit.

tonë. Procesi i industrializimit dhe i urbanizimit dhe elementet e tjera strukturale patën efekte shumë pozitive në të gjitha lëvizjet demografike dhe sociale. Me të vërtetë, kompleksi demografik i Kosovës mbet ende specifik deri para disa vitesh, por duhet përmendur karakterin afatgjatë të proceseve demografike^{13a} sidomos të lëvizjes natyrore, e veçanërisht të natalitetit. Ambienti social i Kosovës i ngarkuar me shumë elemente tradicionale dhe patriarkale, me norma të veçanta morale, me doke, me botëkuptime specifike religjioze, psikologjike etj. luajnë rol të rëndësishëm në riprodhimin e popullsisë dhe kanë tendencë afatgjate, kështu që këto procese, edhe sikur të ishte realizuar në Kosovë një transformim më intensiv në strukturën shoqërore-ekonomike, do të kishin ndikuar në rënien shumë të vogël të shkallëve të natalitetit dhe të shtimit natyror. Në anën tjetër, pikërisht për shkak të natyrës afatgjatë të rrjedhimeve demografike, efektet e veta në këtë drejtim, ka edhe zhvillimi i përpam demografik, i paraluftës. Në Kosovë për një periudhë shumë të gjatë nataliteti është shumë i lartë. Ky nivel i natalitetit, madje edhe rritja e mëtejme e tij si pasojë e kompenzimit të popullsisë së humbur dhe të çrregullimit të martesave etj. gjatë luftës, është mbajtur deri në vitin 1965. Prej këtij viti vërehen tendencat e para të rënies graduale të tij.

Mirëpo, edhe përkundër rënies më të ngadalshme të natalitetit dhe të mortalitetit në Kosovë nga viset e tjera të vendit si pasojë e zhvillimit më të vonshëm ekonomik dhe shoqëror dhe të karakterit afatgjatë të proceseve demografike, u bënë ndryshime edhe në lëmin ekonomik dhe social edhe në zhvillimin demografik, madje edhe në karakteristikat biologjike të popullsisë së kësaj Krahine. Këto ndryshime janë të dukshme sidomos te popullsia jobujqësore. Ky është i kuptueshëm me që është fjala për një shtresë sociale, e cila dallohet esencialisht për nga mënyra dhe kushtet e jetesës nga shtresat e tjera të popullsisë. Ndryshimet në shkallë të natalitetit në mes popullsisë bujqësore dhe asaj jobujqësore të Kosovës në vitin 1953 ishin mjaft të mëdha, reth 10 promil, ndërsa në vitin 1961 rreth 8 promil. Mirëpo, këto shkallë nuk ndryshuan në shtresën përkatëse për 8 vite. Varacionet në mes këtyre dy kategorive të popullsisë ishin sidomos të mëdha te mortalitetit, i cili te të dy shtresat zbriti mjaft për 8 vitet, por ndryshimet mbetën në vitin 1961 rreth 13 promil. Në të dy vitet në fjalë ndryshimet në shkallët e shtimit natyror nuk ishin shumë të mëdha: në vitin 1953 shtimi natyror ishte më i lartë se popullsia jobujqësore, e kjo është pasojë e shkallës shumë më të ulët të mortalitetit, ndërsa në vitin 1961, me rënien e vdekjes, edhe te popullsia bujqësore u rrit shtimi natyror, madje për 10 promil (Tab. 2.).

^{13a} Në demografi, për shkak të tendencës afatgjate të proceseve demografike „vitet konsiderohen si dekada, ndërsa dekadat si shekuj” (D. V o g e l n i k, *Slovenački demografski trenutak: 1970—2000* Prvi slovenački demografski simpozij, Ljubljana, 13 i 14 mart 1974.

T a b e l a. 2. Shkallët e natalitetit, mortalitetit dhe të shtimit natyror të popullsisë së përgjithshme, asaj bujqësore dhe jobujqësore të Kosovës dhe të Sllovenisë në vitin 1953 dhe 1961¹⁴

	Popullsia e përgjithshme		Popullsia bujqësore		Popullsia jobujqësore	
	1953	1961	1953	1961	1953	1961
<i>Kosova</i>						
Nataliteti	42,8	42,1	45,4	44,9	36,1	37,2
Mortaliteti	20,7	12,2	24,4	13,8	11,3	9,4
Shtimi natyror	22,1	29,9	21,1	31,1	24,8	27,8
<i>Sllovenia</i>						
Nataliteti	23,0	18,2	19,8	16,2	25,4	19,1
Mortaliteti	10,2	8,8	11,1	10,1	9,5	8,2
Shtimi natyror	12,8	9,4	8,7	6,1	15,8	10,9

Është interesant se nën ndikimin e proceseve dinamike të zhvillimit ekonomik dhe të veprimtarive shoqërore pas luftës, shkallët e karakteristikave vitale të popullsisë së të gjitha viseve të tjera të Jugosllavisë, ranë. Kjo rënie është mesatarisht 6 deri në 8 promila (Sllovenia, Vojvodina, Serbia, në Kroaci madje edhe më tepër se 15 promila), për Jugosllavinë rreth 10 promila, ndërsa për disa vise, të cilat gjithashtu në pikëpamje sociale-ekonomike janë të pazhvilluara dhe, në një mënyrë, të ngarkuara me veçori tradicionale, prandaj edhe më afër Kosovës, kjo rënie është shumë e madhe dhe mesatarisht sillet më se 15 promila (Bosna e Hercegovina, Maqedonia, Mali i Zi) në periudhën 1954-1973. Kurse edhe në Kosovë nataliteti ka rënë, mirëpo duke marrë parasysh nivelin e tij shumë të lartë (mbi 40 promila deri në vitin 1965), kjo rënie prej 6-7 promilave është mjaft e vogël. Mesatarisht sipas periudhave shkallët e rënies së tij sillen vetëm deri në 2 promil.

Ky nivel shumë i lartë i natalitetit të kësaj Krahine dhe rënia e vogël në krahasim me të, ndërsa rënia e konsiderueshme e tij në viset e tjera të vendit, jo vetëm që ndikoi në zvogëlimin e diferencave regjionale të dinamikës së brendshme demografike, por shkaktoi ndryshime edhe më të mëdha regjionale. Kështu, p.sh. varacionet regjionale në vitin 1973 janë rreth 22 promil (më se 35: rreth 13 promilave). Një situatë të tillë kemi edhe në shtimin natyror, ku ndryshimet në mes këtyre dy territoreve në vitin 1973 sillen rreth 26 promila (28:2,2 promilave), ndërsa variacionet në shkallët e mortalitetit, derisa gjer në vitin 1965, ishin mjaft të mëdha, tash janë zvogëluar, dhe për shkak të strukturës së vjetëruar të popullsisë së disa viseve

¹⁴ B. M a k s i m o v i ć, *Prelazak poljoprivrednog stanovništva u nepoljoprivredne delatnosti*, „Stanovništvo”, nr. 1, IDN, CDI, Beograd 1964, f. 13.

(Sllovenisë, Vojvodinës, Kroacisë, etj), përndryshe me kushtet shumë të përshtatshme socialo-medicinale, mortaliteti i përgjithshëm në to është madje më i lartë edhe se ai i Kosovës (Tab. 3).




Fig. 3. Zhvillimi i shtimit natyror të popullsisë së tri viseve tona karakteristike popullore në periudhat përkatëse

Pikërisht për shkak të rënies rapide të mortalitetit, (prej 18,0 promila në periudhën 1950-1954 në 8,0 promila në periudhën 1970-1973), sidomos të mortalitetit infantil, si pasojë e të arriturave të përgjithshme sanitare, sociale, ekonomike dhe kulturore, shkalla e shtimit natyror të kësaj Krahine është shumë e lartë, e cila edhe në për-

T a b e l a 3. Lëvizja natyrore e popullsisë së Kosovës dhe e disa viseve të Jugosllavisë 1950-1973¹⁵

Mesatarja në Periudha	1950-1954	1955-1959	1960-1964	1965-1969	1970-1973
<i>Nataliteti</i>					
Jugosllavia	28,8	24,6	22,0	19,8	17,9
Sllovenia	22,8	19,4	18,0	17,6	16,9
Vojvodina	22,3	18,4	16,2	14,5	12,7
Maqedonia	38,4	34,0	29,4	26,4	23,6
Kosova	43,5	42,3	41,5	39,1	36,1
<i>Mortaliteti</i>					
Jugosllavia	11,8	10,4	9,4	8,7	8,9
Sllovenia	10,9	8,7	9,6	10,1	10,5
Vojvodina	12,4	10,3	9,7	9,6	10,2
Maqedonia	14,5	11,7	9,8	8,1	7,7
Kosova	18,0	15,7	13,0	9,7	8,0
<i>Vdekja e foshnjeve</i>					
Jugosllavia	115,6	98,5	81,6	62,4	47,1
Sllovenia	70,8	45,4	30,1	27,0	20,6
Vojvodina	120,2	89,7	65,4	46,4	28,7
Maqedonia	138,7	126,3	111,8	96,5	80,1
Kosova	154,6	144,5	132,8	106,0	83,5
<i>Shtimi natyror</i>					
Jugosllavia	17,0	14,2	12,6	11,1	8,1
Sllovenia	11,9	9,7	8,4	7,6	6,4
Vojvodina	10,9	8,1	6,5	4,8	2,5
Maqedonia	23,9	22,3	19,6	18,2	15,1
Kosova	25,5	26,6	28,7	29,4	28,0

masa botërore mund të konsiderohet si e jashtëzakonshme (Krahaso Tab. 1). Ky shtim shumë i lartë natyror i popullsisë së Kosovës është edhe baza kryesore e ekspansionit dhe e eksplozionit demografik të saj. Procesi ekspansiv i shtimit natyror dhe i shtimit të përgjithshëm të popullsisë, e ka përfshirë Kosovën sidomos në këto 15 vjetët e fundit. Vetëm në periudhën 1961-1971 popullsia e kësaj Krahine shtohet për 30%, ndërsa në periudhën 1948-1971 për 70% kurse në periudhën 1921-1971, edhe përkundër emigracioneve të popullsisë së saj para dhe pasluftës, numri i popullsisë së kësaj Krahine shtohet për gati 200%. Ky shtim shumë i madh i popullsisë edhe është në kushtet e tanishme të zhvillimit jo të mjaftueshëm shoqëror-ekonomik një ndër problemet kyçe preokupuese, sepse ai bën shtypje në rradhë të parë në inkuadrimit, shkollimit, standardin jetësor, i cili edhe

¹⁵ Burimi: D. B r e z n i k, *Demografski metodi i modeli*, IDN, CDI, Beograd 1972, f. 172; për vitin 1972 dhe 1973 burimi: *Statistički godišnjak Jugoslavije*, Beograd 1974.

ashtu është më i ulët në vend dhe në të gjitha lëmenjtë e jetës ekonomike, shoqërore dhe kulturele. Madje, sipas proceseve të tashme të lëvizjes natyrore të popullsisë, ekspansioni popullativ i kësaj Krahine do të zgjasë ende, sepse në shumë pjesë të saj shkallët e mortalitetit janë ende në nivel të lartë dhe me përmirësimin e situatës së përgjithshme sociale, shëndetësore, ekonomike dhe kulturele, pritet që ato të zvogëlohen, ndërsa shkalla e natalitetit të mbetet ende në nivel shumë të lartë.

Mirëpo, edhe përkundër zbritjes së konsiderueshme të vdekjes në nivel të Krahinës, prapsepapë në disa komuna dhe pjesë të tyre shkalla e mortalitetit, është mjaft e lartë. Dhe mbi këtë shkallë ende të lartë të vdekjes së përgjithshme ndikon mjaft shkalla shumë e lartë e mortalitetit të foshnjeve dhe të fëmijëve. Ky mortalitet i foshnjeve edhe paraqet një ndër problemet aktuale sociale dhe demografike të Kosovës. Lufta kundër vdekjeve infantile dhe të fëmijëve është një ndër detyrat kryesore të institucioneve përkatëse sociale-shëndetësore dhe të tjera. Shkalla e lartë e mortalitetit infatil hyn në rradhën e faktorëve dominantë, i cili ndikon mbi shkallën e lartë të natalitetit të popullsisë së Kosovës, sepse te popullsia e saj, meqenëse më shumë se gjysma e fëmijëve vdesin pa e mbushur një vit, është rrënjësor psikologjia se ajo në pikëpamje demografike mund të përparojë vetëm në saje të lindjes së shumë fëmijëve, të arritjes së nivelit fiziologjik të lindjeve. Kjo rrjedhë korelative në mes natalitetit dhe mortalitetit është vërtetuar në shumë shembuj të popullatave të ndryshme.¹⁶ Në Kosovë më e lartë është vdekja e foshnjeve nga shkaqet ekzogjene, ndryshe nga viset e tjera, ku ajo është më e madhe nga arsyet endogjene.¹⁷ Diferencat në shkallët e mortalitetit të foshnjeve ekzistojnë edhe në mes të foshnjeve të gjinisë mashkullore dhe femërore. Derisa në të gjitha viset e Jugosllavisë më shumë vdesin foshnje të gjinisë mashkullore, në Kosovë vdesin më shumë foshnje të gjinisë femërore. Psh. në Kosovë në vitin 1970 shkalla e mortalitetit të foshnjeve për meshkujt ishte 94,1 promila, ndërsa për femërat 105,3, kurse në Slloveni ky raport ishte 23,7:21,5 promila.¹⁸ Ky ndryshim në Kosovë në dëm të foshnjeve të gjinisë femërore, është rezultat i ndikimit të shumë faktorëve, por dominant është ai etnopsikologjik dhe patriarkal; këtu duhet përmendur moskujdesin e duhur ndaj të lindurve të gjallë të gjinisë femërore, që në kushtet jo të volitshme socialo-medicinale, vdesin më shumë, madje shpeshherë të shëndoshë fiziologjikisht. Kjo dukuri është karakteristike e popullsisë shqiptare, e cila në fëmijët e gjinisë mash-

¹⁶ A. L a n d r y, *Traité de démographie*, Paris 1949, p. 538—540.

¹⁷ Me studimin e mortalitetit të foshnjeve më shumë është marrë demografi i njohur francez J. B o u r g e o i s — P i s h a t, i cili gjithashtu e ka bërë edhe tipizimin e tij në shkaqe endogjene dhe ekzogjene (Shih studimet e tij: *De la mesure de la mortalité infantile*, „Population”, janviers—mars, Paris 1946; *La mesure de la mortalité infantile I principes et méthodes*, „Population” avril—juin, Paris 1951; *La mesure de la mortalité infantile: les causes de décès*, „Population”, juillet—septembre, Paris 1951; *Evolution récente de la mortalité infantile*, „Population” nr. 3, Paris 1949, p. 538—540.

¹⁸ *Statistički godišnjak Jugoslavije*, Savezni zavod za statistiku Jul 1972, f. 348.




Fig. 4. Mortaliteti i foshnjeve në Kosovë në vitin 1960 dhe në vitin 1970

kullore që në fëmijni sheh një prosperitet ekonomik dhe social. Në këtë Krahinë vdekja më e madhe e femrave është edhe në grup-moshën 30-39 vjeç, si pasojë e komplikimeve të shumta lidhur me shtatëzaninë dhe lindjen për shkak të shkallës së lartë të fertilitetit, etj.¹⁹

Ndonëse struktura demografike e Kosovës u zbërthye vonë për shkak të zhvillimit të ngadalshëm ekonomik dhe shoqëror dhe të strukturës homogjene ekonomike e sociale, si dhe të vetë karakterit afatgjatë të proceseve demografike, prapsepapë në këto dhjetë vjetët e fundit vërehen variacione të ndryshme regjionale në komponentët e lëvizjes natyrore të popullsisë (Tab. 4) dhe në tërë kompleksin demografik.²⁰

Shkalla e variacioneve regjionale të natalitetit të popullsisë së Kosovës është mjaft e gjerë sepse ndryshimet në mes komunave sillen 10 deri 15 promila në disa periudha. Natyrisht këtu, dhe nga shumë krahasime të tjera duhet përjashtuar komunën e Leposaviqit, sepse atë e karakterizon situata më e volitshme demografike-sociale dhe rrethanat e veçanta etnike. Shkallët e lindjeve në këtë komunë pas luftës silleshin prej 32 deri më 16 promil. Dhe ato janë më të ulëta në Krahinë, përgjysmë më pak se mesatarja e Krahinës në periudhën 1967-1971 dhe rreth tri herë më të ulëta se sa në disa komuna në të njëjtën periudhë. Derisa për Krahinë në tërësi shkallët e natalitetit pas luftës silleshin prej 43 deri në 36 promila, ato në disa komuna sillen prej 56 deri në rreth 40 promila deri në vitin 1960. Në decenien e fundit ato në disa komuna zbresin në nivel prej rreth 35 promil, ndërsa në disa komuna të tjera mbeten ende shumë të larta, rreth 50 promil e më tepër. Dhe, sa më shumë po thellohen diferencat regjionale në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror në mes komunave në periudhën më të re, aq më tepër po rriten variacionet regjionale të variabilave demografike. Në periudhën 1967-1971 psh. ndryshimet në shkallët e natalitetit janë rreth 15 promil.

Shkallët ekstreme të natalitetit janë sidomos në ato komuna ku pjesën më të madhe dhe dominante përbën popullsia shqiptare. Të gjitha këto komuna dallohen për shkallë të lindjeve rreth 45 promil në periudhën 1967-1971 (Suhareka, Gllgovci, Rahoveci), ndërsa në disa vite edhe mbi 50 promil.

Variacionet regjionale janë gjithashtu karakteristike edhe për shkallët e mortalitetit, sidomos atij infatil, dhe të shtimit natyror. Psh. shkalla e mortalitetit të përgjithshëm në disa komuna është për disa promil më e lartë se në komunat e tjera (12:6 promil), ose ndryshimet në mortalitetin e foshnjeve ku në disa komuna shkalla e tij arrin në vitin 1971 deri në 120 promil, në krahasim me shkallën më të ulët rreth 50 promil. Kjo don të thotë se diferencat në mes popullatave të zhvilluara, psh. në mes të popullsisë së Sllovenisë dhe të disa komunave tona dallimi është për 100 promil (120:20 promilave). Va-

¹⁹ D. B r e z n i k, *Demografski pregled*, „Stanovništvo”, nr. 2, Beograd 1966, f. 142.

²⁰ H. I s l a m i, *Regionalne osobenosti razvoja stanovništva Kosova u razdoblju 1961-1971. godine kao funkcija socijalno-ekonomskih kretanja*, Beograd 1974, (në shtyp).

Tabela 4. Komponentet e lëvizjes natyrore të popullsisë së Kosovës prej vitit 1957 deri në vitin 1972, sipas komunave në periudhat përkatëse në promilë:

Komuna	Nataliteti			Mortaliteti			Shtimi natyror					
	1957 1961	1962 1966	1967 1971	1957 1961	1962 1966	1967 1971	1957 1961	1962 1966	1967 1971	1972		
1. Deçani	38,5	38,6	38,1	44,7	14,3	11,4	8,5	7,4	24,2	27,2	29,6	37,3
2. Dragashi	53,1	51,3	43,8	41,2	19,8	17,9	11,6	11,6	33,3	33,4	32,2	29,6
3. Gjakova	43,4	43,5	41,1	40,9	13,7	13,0	10,6	8,3	29,7	30,5	30,5	32,6
4. Gllgovci	46,1	45,3	44,4	45,5	17,4	13,7	9,3	7,6	28,7	31,6	34,1	37,9
5. Gilani	43,7	41,5	36,6	37,5	15,8	13,2	9,5	8,1	27,9	28,3	27,1	29,4
6. Istogu	42,5	37,4	34,3	35,8	13,2	10,6	7,6	6,9	29,3	26,8	26,7	28,9
7. Kaçaniku	49,1	46,6	41,1	42,1	19,5	15,5	10,7	8,5	29,6	31,1	31,7	33,6
8. Klina	45,2	42,1	40,5	41,7	16,7	12,5	9,6	7,5	28,5	29,6	30,9	33,9
9. Kamenica	42,4	34,1	29,4	30,5	15,6	9,8	6,6	6,8	26,8	24,3	22,8	23,7
10. Mitrovica	38,1	34,8	32,6	30,0	10,8	9,6	7,8	7,6	27,3	24,2	24,8	22,4
11. Leposaviqi	31,3	19,9	16,8	20,6	8,6	7,5	6,7	7,7	22,7	12,4	10,1	12,9
12. Lipjani	41,4	38,3	35,1	36,8	13,1	10,3	7,4	7,8	28,3	27,0	27,7	29,0
13. Rahoveci	48,6	49,5	45,9	44,7	20,0	17,2	11,3	9,3	28,6	32,3	34,6	35,4
14. Peja	38,4	38,9	35,4	31,6	12,1	10,1	8,6	7,1	26,3	28,7	26,8	24,5
15. Podujeva	40,2	36,9	35,6	37,5	12,1	10,0	7,6	7,6	28,1	26,9	28,0	29,9
16. Prishtina	39,1	38,9	36,5	33,3	11,0	9,6	7,8	6,7	28,1	29,3	28,7	26,6
17. Prizreni	43,2	42,9	40,4	38,1	14,4	12,9	10,5	8,7	28,8	30,0	29,9	29,4
18. Sërbica	44,4	39,4	37,3	40,7	16,2	13,9	8,6	7,3	28,2	25,5	28,7	33,4
19. Suhareka	47,1	47,4	45,7	46,0	18,2	14,6	10,8	9,6	28,9	32,8	34,9	36,4
20. Ferizaji	38,9	38,3	37,4	37,0	14,5	11,7	9,1	8,6	24,4	26,6	28,3	28,8
21. Vitia	43,3	41,3	38,8	41,7	17,3	12,0	9,9	9,5	26,0	29,3	28,9	32,2
22. Vuçitërna	43,3	41,8	37,3	36,5	13,9	11,1	8,5	8,1	29,5	30,7	28,8	28,4
Kosova	41,8	40,0	37,2	37,1	14,0	11,8	8,7	7,9	27,8	28,2	28,5	29,2

riacionet janë të mëdha gjithashtu edhe në shkallët e shtimit natyror, dhe ato sillen prej rreth 22 promil në më se 35 promil, duke përjashtuar komunën e Leposaviqit (Krh. Tab. 4., Fig. 2 dhe Fig. 4).

Këto variacione bukur të theksuara regjionale në karakteristikat vitale të popullsisë së Kosovës prej vitit në vit dhe prej periudhës në periudhë, tregojnë se në Kosovë ende nuk është stabilizuar lëvizja natyrore e popullsisë. Prandaj, në të ardhmen edhe pritet të

²¹ Burimi: Të dhënat e Entit Krahinor të Statistikës, Prishtinë 1973.




Fig. 5. Lëvizja e mesatares të jetës së popullsisë të Kosovës dhe të Vojvodinës

ndenca e rënies së shkallëve të komponenteve natyrore të popullsisë së kësaj Krahine. Posaçërisht pritet rënia e mortalitetit, e sidomos e atij të foshnjeve.

Në fund duhet theksuar se këto shkallë të larta të fenomeneve vitale të popullsisë së Kosovës janë rezultat i ndikimit të një morie faktorësh, dhe ato janë karakteristikë e popullsisë shqiptare. Prandaj, edhe të gjitha diferencat regjionale janë pasojë e strukturës së ndryshme nacionale të popullsisë nëpër komuna. Psh. ndryshimet në shkallët e natalitetit në mes shqiptarëve dhe serbëve në Kosovë në vitin 1971 janë rreth 20 promila (42,2:22,4 promila), ndërsa në mes malazezëve dhe shqiptarëve në të njëjtin vit janë për më se 22 promila (19,6:42,2 promilave). Përpara këto ndryshime ishin më të vogla, ndërsa ato të mortalitetit më të mëdha. Në vitin 1953 psh. ndryshimi në vdekjen e përgjithshme në mes shqiptarëve dhe serbëve ishte rreth 11 promila (25,1:13,8 promilave), ndërsa tash është zvogëluar dukshëm. Mirëpo tash variacionet janë shumë të mëdha në shtimin natyror të popullsisë dhe ato sillen rreth 18 promil (në vitin 1971 shqiptarët 33,6 promil, ndërsa serbët 15,6) etj.²²

²² Demografske, socijalne i ekonomske karakteristike stanovništva nacionalnosti u Jugoslaviji, Institut društvenih nauka, Centar za demografska istraživanja, (Studija iz rađena na zahtev Centra za društvena istraživanja pri Predsedništvu SKJ, i službi za internu upotrebu), Beograd, novembar 1973, f. 31.

Duke marrë parasysh situatën jo të njejtë sociale-ekonomike të këtyre kombësive në Kosovë dhe të kaluarën jo të njejtë historike dhe politike të tyre, si dhe faktorët tjerë me karakter tradicional dhe patriarkal, atëherë është i kuptueshëm trendi po i njëjtë i këtyre dukurive të përmendura demografike. Sa u përket kombësive është interesant se kur analizohet situata ekonomike dhe sociale në mes shqiptarëve dhe kombësive të tjera që janë në numër, vërehen diferenca shumë të mëdha. Kështu psh. sipas regjistrimit të vitit 1971, pjesëmarrja e shqiptarëve në të gjitha veprimtaritë primare është më e madhe edhe se mesatarja e Krahinës, ndërsa më e vogël se sa mesatarja e Krahinës, dhe e kombësive të tjera, është pjesëmarrja e tyre në veprimtaritë sekondare dhe terciare dhe më e madhe pjesëmarrja e tyre në emigrimin ekonomik në botën e jashtme.²³ Për veçoritë demografike dhe sociale të popullsisë së Kosovës sipas kombësive do të bëhet fjalë imtësisht në një punim tjetër.

Të gjitha ndryshimet ekonomike, sociale, shëndetësore dhe kulturele ndikuan pozitivisht edhe në ndryshimet në mestaren e jetës së popullsisë.²⁴ Është sidomos pozitive zgjatja e jetës së femrave të kësaj Krahinë. Jeta në periudhën 1952-1969 u zgjat për afro 19 vjet, dhe prej vitit 1965 jeta e saj është më e gjatë se e mashkullit të kësaj treve. (Fig. 5). Ky fakt tregon se pozita e femrës, edhe e asaj shqiptare, është përmirësuar bukur shumë në shoqëri dhe në familje. Këtë e ka mundur ngritja e nivelit arsimor dhe kultural dhe emancipimi social. Femra shqiptare madje është liruar nga shumë paragjykime patriarkale dhe tradicionale e të gjitha këto ndryshime kanë edhe efektet e veta pozitive në të gjitha lëminjtë e jetës ekonomike, shoqërore dhe kulturele.

Hivzi Islami

LE DÉVELOPPEMENT DES COMPOSANTES DE LA DYNAMIQUE NATURELLE DE LA POPULATION DU KOSOVO

R é s u m é

Il est intéressant de suivre d'une manière systématique la situation démographique de chaque région, de connaître les facteurs qui constituent les processus démographiques et d'observer les conséquences qui découlent de la reproduction non-rationnelle de la population. L'espace qui se distingue dans son mouvement non favorable de l'ensemble démographique et surtout

²³ *Po aty*, f. 167.

²⁴ Mesatarja e jetës së njeriut është pasqyrë e mortalitetit të popullsisë në të gjitha grupet e moshës dhe nënkupton numrin mestar të viteve që do të jetojë fëmija i lindur sot vetëm me kusht që të mos shkaktohen ndryshimet e vdekjes nga gjendja që vërehet në atë vit.

dans son mouvement naturel de la population, non pas uniquement en Yougoslavie et en Europe, mais aussi sans doute dans le monde entier et la Province du Kosovo. Beaucoup d'éléments du complexe démographique et social du Kosovo étaient jusqu'à présent identiques avec le développement des masses de la société pré-industrielle et traditionnelle.

La situation démographique complexe du Kosovo, aussi bien que celle économique et sociale est le fruit de circonstances spécifiques, socio-historiques et politiques du passé récent et lointain, ainsi que du très bas niveau de développement socio-économique, médical et culturel. Ces circonstances se sont manifestées entre autre aussi dans les processus vitaux de la population de cette région. Leur développement peut se suivre dès l'année 1911, car depuis lors existent des données sur la dynamique intérieure de la population du Kosovo (Fig. 1). Ces conséquences démographiques non-rationnelles, avec des oscillations assez prononcées encore récemment, sont compréhensibles. En effet jusqu'à la deuxième guerre mondiale, on ne peut même pas parler du développement des forces productives, mais uniquement du total sous-développement social et économique, de la pauvreté et de la misère. Malgré le haut degré de natalité jusqu'en 1920, l'accroissement naturel de la population tournait autour de deux ou trois pour mille. C'était une conséquence de la mortalité énorme, surtout infantile et de celle des femmes d'âge reproductif, causée par différentes maladies endémiques et épidémiques comme par exemple la malaria, la diphtérie, la tuberculose, la peste etc... qui faisaient des ravages.

La structure non-favorable socio-médicale, économique et culturelle se remarque même après la deuxième guerre mondiale, et jusqu'aux années 60. D'autre part, le caractère des processus démographiques lui-même est tel qu'ils réagissent toujours plus tard aux changements des développements socio-économiques; c'est pourquoi les échelles des mouvements naturels de la population du Kosovo, surtout de la natalité et de l'accroissement naturel, restent d'un niveau très haut même après les années '60 (Fig. 2). Dans ce sens, il faut noter les effets spécifiques qu'exercea l'ambiance sociale même du Kosovo, chargée de nombreux éléments traditionnels et patriarcaux, de normes morales spéciales, de vieilles coutumes et de points de vue religieux et psychologiques etc... Ces processus de longue durée, ces derniers temps jouèrent un rôle important dans la reproduction de la population malgré des transformations apparentes, surtout parmi la population albanaise très féconde. Leur influence se manifesterà encore plus tard non seulement dans le mouvement naturel de la population, mais aussi dans les autres composantes démographiques et sociales.

La chute de la mortalité est un des changements révolutionnaires qui se produisit après la guerre dans le développement de la population du Kosovo. La mortalité générale a diminué d'à peu près 20 pour mille, tout de suite après la guerre à 0,8 pour mille en 1973, celle des enfants en bas âge de 160 pour mille à moins de 80 pour mille. Il s'en suit qu'à cause de ces changements rapides dans la diminution de la mortalité, due aux résultats des réalisations générales sanitaires, sociales, économiques et culturelles; le degré d'accroissement naturel de la population de la région a augmenté davantage (Tab. 3 et 4, Fig. 3). Le degré actuel de l'accroissement naturel même dans le monde entier est considéré comme extraordinaire. Cet accroissement naturel très élevé de la population du Kosovo est aussi à la base principale de son expansion et de son explosion démographique. C'est pourquoi l'accroissement naturel et général du Kosovo est et reste une des caractéristiques particulières de sa population. Elle conditionne des phénomènes et des processus du mouvement quantitatif et qualitatif de la population, ainsi que beaucoup de problèmes économiques et sociaux de cette région. Par exemple seule dans la période de 1961-1971 la population du Ko-

ssovo s'est accrue de 30%, dans la période de 1948-1971 de 70%, alors que dans la période de 1921-1971, malgré les émigrations et la deuxième guerre mondiale son nombre a augmenté de 200%.

En ce qui concerne le degré du mouvement naturel de la population de la dernière décennie, on remarque des variations de la moyenne de la région assez prononcées parmi les communes (tab. 4, Fig. 4). En vertu de ces changements régionaux de quelques pour mille parmi les communes, d'une période à l'autre, on peut conclure que le niveau de degrés des processus vitaux n'est pas toujours stabilisé mais on espère qu'ils vont diminuer continuellement. On peut également remarquer des tendances d'augmentation dans la durée de la moyenne de vie de cette population.

